



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Ekstrakt,

i procesverbalit të mbajtur më 05 shkurt 2016, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, në diskutimin publik për propozim Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Podujevës për periudhën 2016 – 2018, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01-006-7411 të datës 29 janar 2016

Takimi filloi në orën 10:10

Takimin e hapi dhe e kryesoi, z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, ndërsa për fjalën hyrëse, sqarimet dhe marrjen e propozimeve u kujdes z.Avni Fetahu drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe i Autorizuar për ushtrimin e kompetencave nga fushëveprimtaria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe drejtorët e Drejtorive të Komunës, përfaqësues të bizneseve dhe një numër i qytetarëve (sipas listës së nënshkrimeve të bashkëngjitur).

➤ **Propozim Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal në Komunën e Podujevës për periudhën 2016-2018**

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke falënderuar për pjesëmarrje, ndër të tjera theksoi, sigurisht jeni në dijeni se lajmërimi për këtë diskutim publik me qytetarë është bërë me kohë në mjete të informimit, në veb-faqe të Komunës duke për fshirë edhe atë të facebook dhe në tabelën e shpalljeve në hyrje të objektit të Komunës, dhe në këtë aspekt është pak sa për shqetësim numri i vogël i pjesëmarrësve në këtë diskutim, mirëpo si do që të jetë, draft Strategjia përkatëse është në diskutim publik 2 muaj dhe kushdo që ka propozime, vërejtje dhe sugjerime të ndryshme, ato mund t'i paraqet në formë të shkruar dhe në mënyrë elektronike në Zyrën e Informimit dhe në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. Janë të mirëseardhura të gjitha sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet e qytetarëve dhe që të gjitha do të shqyrtohen në fazat e ardhshme ku të gjitha ato të cilat konsiderohen si të rëndësishme sigurisht se do të inkorporohen në dokumentin final i cili do të propozohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Dokumenti i draft Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Podujevës për periudhën 2016-2018 është hartuar nga Kompania Management and Development Associates (MDA) nën mbikëqyrjen e Grupit punues të ngritur me vendim nga Kryetari i Komunës.

Në dokument janë përfshirë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me gjitha sektorët, kategoritë dhe specifikat e Komunës së Podujevës, për sqarime më të hollësishme fjalën ja jap z.Avni Fetahut.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, dhe i Autorizuar për ushtrimin e kompetencave nga fushëveprimtaria e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, fillimisht përshëndeti të pranishmit dhe falënderoj për pjesëmarrje, dhe shtoi, draft dokumenti është hartuar nga Kompania Management and Development Associates (MDA) në bashkëpunim me Grupin punues i cili është ngritur nga Kryetari i Komunës. Për hartimin e këtij dokumenti fillimisht neve na është dashur të grumbullojmë të dhëna nga të gjitha fushat sa i përket territorit të Komunës së Podujevës, pastaj është marrë parasysh dhe është analizuar gjendja aktuale si dhe në fund janë paraqitur prioritetet për të ardhmen gjithnjë duke u bazuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet përkatëse, në Buxhetin e Komunës së Podujevës për vitin 2016 dhe në planifikimet buxhetore për vitet përkatëse. Në kuadër draft Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal për Komunën e Podujevës për vitet 2016-2018 është përgatitur edhe harta interaktive e cila është mjaft e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Podujevës, gjithashtu është paraqitur edhe amza e projekteve të parapara për Komunën e Podujevës.

Vlen të ceket se pas miratimit final nga ana e Kuvendit të Komunës, dokumenti do të përkthehet në dy gjuhë, Anglisht dhe Gjermanisht, për arsye që investitorët e jashtëm potencial të kenë qasje sa më të lehtë në këtë dokument.

Jemi të hapur për të gjitha propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet e juaja si të gjitha alternativat konkrete të qytetarëve me qëllim që dokumenti final të jetë sa më i pasur dhe i kompletuar.

(Në vazhdim me projektor, drejtori prezanton hartën interaktive dhe jep sqarimet e nevojshme)

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, para se të hap debatin, dëshiroj të ju njoftoj se harta interaktive është mjaft e rëndësishme dhe mëse e domosdoshme për investitorët e jashtëm potencial ngase në hartë janë të paraqitura të gjitha të dhënat për secilin lokalitet veç e veç.

z.Ilmi Bunjaku, nga fshati Sallabajë, theksoi, përgëzoi Komunën e Podujevës për hartimin e këtij dokumenti, mirëpo kam vërejtur se në dokument figuron Banja e Lluzhanit kurse duhet të jetë Banja e Sallabajës ngase banja është në territorin e Sallabajës e jo në territorin e Lluzhanit, andaj propozoj të korrigjohet.

z.Naim Çunaku, këshilltar në Kuvendin e Komunës, meqë unë vie nga lokaliteti për të cilin parafolësi e ngriti çështjen që ka të bëjë me territorin e Banjës, ju informoj se në cilësinë e këshilltarit të Kuvendit të Komunës së Podujevës përkatësisht anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa, këtë çështje e kam ngritur në dy mbledhjet e fundit dhe është hy si konstatim që të bëhet korrigjimi përkatës. Të gjithë jemi në dijeni se Banja gjendet në zonën kadastrale të fshatit Sallabaj, andaj edhe është me të drejtë të kërkohet një gjë me tillë, ndërsa qytetarët kanë të drejtë ta quajnë si të dëshirojnë vetë.

z.Lutfi Rexhepi, këshilltar në Kuvendin e Komunës, theksoi, lidhur me draft Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal, dua t'i parashtroj pyetjet, si në vijim

1-lidhur me çështjen e pronave, a është menduar që Komuna të ndërmer hapat e nevojshme për kthimin e pronave të veta të cilat aktualisht janë nën menaxhimin e AKP-së.

2-a është menduar që Komuna e Podujevës të ndahet në disa zona funksionale në mënyrë që orientimet e veprimtarive të jenë me specifika konkrete dhe planifikime të investimeve të caktuara.

z.Avni Fetahu, përgjigje parafolësit, sa i përket pyetjes 1, në fakt është mundësia ligjore në bazë të të cilës Komuna ka të drejtë të kërkoj kthimin e pronave, mirëpo nuk mundet që vetë Komuna të bëjë një gjë të tillë pa pasur vullnet nga ana e nivelit qendrorë, ndërsa lidhur me pyetjen 2, orientimin e veprimtarive, në këtë dokument ne në një formë kemi përfshirë disa zona ekonomike të cilat kanë karakterin e zonave industriale.

z.Nexhmi Rudari, Nënkrjetar i Komunës, theksoi, sa i përket pyetjes së dytë të z.Lutfi Rexhepit, konsideroj se Komuna e Podujevës ka bashkësitë lokale të cilat mendoj se duhet të funksionalizohen dhe në kuadër të kësaj mund të bëhen orientimet e zhvillimit ekonomik përkatës.

z.Bardhyl Musa, nga Kompania Management and Development Associates (MDA), theksoi, sa i përket pyetjeve të parashtruara nga z.Lutfi Rexhepi, unë konsideroj se në këtë dokument është adresuar çështja e pronave komunale të cilat janë në interes të Komunës ku fillimisht parashihet, identifikimi apo inventarizimi i pronave komunale që mund të jepet në shfrytëzim për nevoja ekonomike, si dhe gjatë viteve në vazhdim të përgatiten dhe ofrohen këto hapësira për punë për bizneset që gjenerojnë punësim. Kjo është e paraparë te objektiva Strategjike, Zhvillimi i qëndrueshme pika 1.1 . Gjithashtu, pika 1.4 dhe 1.5 adreson çështjen e partneritetit publiko privat, e cila obligon Komunën që të ngritën kapacitetet e stafit që do te merret me PPP, pastaj të përfundohet një studim fizibiliteti përmes së cilit do krijohet një plan aksional për projektet që mund të realizohen përmes PPP-se.

Sa i përket pyetjes së dytë, konsideroj se në këtë draft Strategji janë adresuar çështja e ndarjeve se hapësirave, për me shume tek objektiva strategjike 1.5, nen objektiva 1.1 dhe 1.2 përcakton se deri ne vitin 2018 duhet te hartohen hartat zonale dhe hartimi i planeve rregulluese detale për zonat urbane.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim, dhe duke u bazuar në atë që diskutimi publik është deri më 28 mars 2016, inkurajoj të gjithë qytetarët të cilët kanë propozime, sugjerime apo vërejtje të ndryshme, në formë fizike por edhe në mënyrë elektronike mund t'i dorëzojnë ato në Zyrën e Informimit dhe në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik në mënyrë që të gjitha ato të cilat konsiderohen si të arsyeshme do të përfshihen në dokumentin final para se të miratohet në Kuvendin e Komunës. E them këtë ngase është me rëndësi që dokumenti final të konsiderohet i hartuar ose përgatitur nga Komuna e Podujevës dhe Qytetarët e Komunës, pra mos të konsiderohet vetëm si dokument i Komunës por të jetë dokument gjithëpërfshirës.

Pra edhe njëherë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje dhe për kontributin e juaj në këtë diskutim publik, dhe kërkoj nga ju që të gjitha pikëpamjet dhe kërkesat që keni në lidhje me këtë draft dokument, të drejtoheni në zyrat e cekura më lartë në mënyrë që dokumenti final të jetë pa lëshime apo vërejtje eventuale.

Takimi përfundoi në orën 10.50

Procesverbalin e mbajti:

Enis Sheholli

**Podujevë,
05 shkurt 2016**

z.Avni Fetahu

**I autorizuar për ushtrimin e kompetencave nga
fushëveprimtaria e
Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik**